



Procesverbal 2/2025

I mbajtur në mbledhjen e II-të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e Osman Eminit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën 27.02.2025 në ora 10⁰⁰ në zyrën e takimeve të Kryetari i komunës.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për komunitete;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
4. Diskutim i anëtarëve të Komitetit për komunitete për takim 1 ditor për planifikim dhe përgatitje të Planit të punës për Vitin 2025, koordinim me zyrën e Kryesuesit Xhavit Zariqi;
5. Rekomandim nga Komiteti për Komunitete për mëditjet e pa paguara për anëtarë të Komitetit për komunitete dhe
6. Të ndryshme.

Pika 1

1. **Flora Abdullahu** – Hap takimin dhe konfirmoi pjesëmarrjen në mbledhje – Prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete;

Pika 2

2. U miratua rendi i ditës pa ndonjë vërejtje;

Pika 3

3. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

Pika 4

Flora Abdullahu – Theksoi se duhet të organizojmë një takim për finalizimin e Planit të punës së Komitetit për komunitete të Komunës së Ferizajt për Vitin 2025, në bashkëpunim me zyrën e kryesuesit dhe organizatat tjera.

Në bisedim me zyrtarin e kryesuesit javën tjetër pritët të na informoi për këtë çështje.

Është takimi i IX-të që nuk kemi marr mëditje për takimet e KK-se, përveç anëtarëve që janë pjesë e asamblesë që marrin me rregullë, duke kaluar përgjegjësinë nga një zyrtarë në tjetër dhe ne kërkojmë që kjo çështje të zgjidhet me të gjithë kompensimin e këtyre mëditjeve.

Të gjitha hallkat ligjore Kryesuesi i KK-së i ka shtjelluar duke kërkuar zgjidhje prej mëditjeve brenda komunës, mirëpo nuk ka zgjidhje. Në takimin e fundit me asistentin e Kryesuesit Xhavit Zariqi, e takuam zyrtaren znj. Fikrete Veliun dhe i treguam problemin që kemi nga e cila s'bashku me zyrtarin e zyrës së kryesuesit të kuvendit na referuan që do të na dërgojnë një email zyrtar të thesarit të Kosovës nga ana e Kryesuesit të KK-së.

Pika 5

Rekomandim: Të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete të cilët nuk janë anëtarë të kuvendit, të nënshkruhen në kërkesën për t'iu dorëzuar Kryesuesit dhe Kryetarit të Kuvendit të Komunës për t'i kompensuar mëditjet të cilat nga muaji Qershor 2024 deri më tani nuk janë kompensuar.

Pika 6

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – E mbylli mbledhjen e Komitetit për komunitete, mbasi nuk pati të interesuar për diskutim në të dryshme.

Procesmbajtësi



Xhemajl Jashari

Kryesuesi i Komitetit për komunitete



Osman Emini